| **Buletini Nr. 202 / 2026, 21-07-2026** | **Parashikimi** nga 21-07-2026, ora 12:00 deri 22-07-2026, ora 23:59. |
|---|---|

## ZJARRET NË PYJE

----------------------

Sot pasdite (e martë, dt. 21) dhe nesër (e mërkurë, dt. 22) pritet nivel rreziku “I LARTË” në qarqet Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Korçë dhe Gjirokastër. Në qarqet Dibër dhe Vlorë pritet nivel rreziku “I MODERUAR”. Në qarkun Shkodër pritet nivel “I ULËT”, ndërsa në qarkun Kukës pritet nivel S’KA RREZIK (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).
Në disa qarqe pritet nivel rreziku lokalisht “I LARTË” konkretisht: qarku Dibër (Jug- Perëndim) dhe qarku Vlorë (Veri-Perëndim).
Rreziku pritet të jetë më i lartë gjatë ditës së sotme.

## PARASHIKIMI METEO

----------------------

### RESHJET

Sot pasdite (e martë, dt. 21) dhe nesër (e mërkurë, dt. 22) priten reshje të dobëta deri lokalisht mesatare në qarqet Shkodër dhe Kukës, shoqëruar me shtrëngata. Në qarqet Dibër, Lezhë, Durrës, Tiranë, Elbasan dhe Berat priten reshje të dobëta, ndërsa në qarqet e tjerë priten reshje lokalisht të dobëta (siç tregohet në tabelë, respektivisht për secilin qark).

### TEMPERATURA

Nesër (e mërkurë, dt. 22) temperaturat minimale dhe maksimale të ajrit pritet të arrijnë:
në bregdet: 22/ 32 °C
në vendet e ulëta: 20 / 33 °C
në vendet malore: 13 / 30 °C

### ERA

Sot pasdite (e martë, dt. 21) dhe nesër (e mërkurë, dt. 22) era pritet të fryjë e lehtë deri mesatare, për momente në bregdet dhe zonat malore deri e fortë.

| ***NIVELET E RREZIKUT*** | **S’KA RREZIK** | **I ULËT** | **I MODERUAR** | **I LART** |
|---|---|---|---|---|

## *PARASHIKIMI I DETAJUAR MBI RREZIQET NATYRORE (SOT DHE NESËR)*

| ***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT*** | ***Zjarre në pyje*** | ***Ngjarje Meteorologjike*** | | | ***Ngjarje Hidrologjike*** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ***Zjarret Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Mesatarja e qarkut*** | ***Reshje 24-orëshe Maksimale të lokalizuara*** | ***Shtrëngata*** | ***Përmbytje të Shpejta*** | ***Përmbytje Lumenjsh*** | ***Rrëshqitje toke*** |
| **SHKODËR** | I ULËT | të dobëta | mesatare |  | | | |
| **KUKËS** | S'KA RREZIK | të dobëta | mesatare |  | | | |
| **DIBËR** | I MODERUAR | të dobëta | | | | | |
| **LEZHË** | I LARTË | të dobëta | | | | | |
| **DURRËS** | I LARTË | të dobëta | | | | | |
| **TIRANË** | I LARTË | të dobëta | | | | | |
| **ELBASAN** | I LARTË | të dobëta | | | | | |
| **FIER** | I LARTË | nuk ka reshje | të dobëta | | | | |
| **BERAT** | I LARTË | të dobëta | | | | | |
| **KORÇË** | I LARTË | nuk ka reshje | | | | | |
| **VLORË** | I MODERUAR | nuk ka reshje | | | | | |
| **GJIROKASTËR** | I LARTË | nuk ka reshje | të dobëta | | | | |

## LEGJENDA: *Reshjet 24-orëshe*

| **Niveli i Rrezikut** | ***Reshje shiu*** (mm / 24 orë) |
|---|---|
| S'KA RREZIK | të dobëta (0 – 15 mm / 24 orë)<br>Nuk priten fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I ULËT | mesatare (15 – 45 mm / 24 orë)<br>Mundësi që të shfaqen fenomene hidro-meteorologjike problematike. |
| I MODERUAR | intensive (45 – 90 mm / 24 orë)<br>Moti parashikohet i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonta hidro-meteorologjike. |
| I LARTË | shumë intensive (> 90 mm / 24 orë)<br>Moti është shumë i rrezikshëm. Parashikohen fenomene të pazakonshme hidro-meteorologjike mjaft intensive. |




***RREZIKU MAKSIMAL I QARKUT***
***për sot dhe nesër, dt. 21 – 22.***

## LEGJENDA: *Zjarre në pyje*

| | |
|---|---|
| S'KA RREZIK | Zjarret e mundshëm janë të kontrollueshëm lehtësisht. |
| ULËT | Barërat e thatë dhe pyjet mund të digjen lehtë. Flakët janë te mesme në pyje dhe të shpejta në zonat e ekspozuara. |
| I MODERUAR | Ndezja e zjarreve mund të ndodhë lehtë dhe me përhapje të shpejtë. Zjarret mund të jenë shumë të nxehtë, me kurora përhapje të vogla dhe të mesme. |
| I LARTË | Ndezja mund të shkaktohet edhe nga një shkëndijë. Zjarret janë shumë të nxehtë me përhapje shumë të shpejtë të flakëve si rrjedhim kontrolli i tyre është shumë i vështirë. |

## SIMBOLE

| | |
|---|---|
| | Shtrëngata: reshje mbi 20 mm/3orë. Moti mund të krijojë probleme të ndryshme |
| | Përmbytje urbane ose nga përrenjtë dhe lumenjtë e vegjël |
| | Përmbytje nga lumenjtë e mesëm dhe të mëdhenj |
| | Rrëshqitje toke |